

KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI"
NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al ,Tel/fax: ++355 47 200 111; Mob, ++355(0)69 40 94 516

Nr. 18 Prot.

Tiranë, më 01/10/2024

Lënda: Relacion Përmbledhës mbi Plotësimin e Pyetësorëve të Pedagogëve për Vitin Akademik 2023 – 2024

Drejtuar: Rektorit të Kolegjit Universitar "Qiriazi"
Prof. Dr. Gjokë ULDEDAJ

Për dijeni: Dekanit të Fakultetit Ekonomik

Prof. Dr. Halit Xhafa

Dekanes së Fakultetit të Drejtësisë

Prof. Asoc. PhD Enida BOZHEKU

Dekanit të Fakultetit të Edukimit, Shkencave Sociale dhe Sportit


Prof. Dr. Vejsel RIZVANOLLI


Drejtuesit të Kolegjit Profesional të Lartë

Prof. Dr. Abdul SINANI

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë të Kolegjit Universitar "Qiriazi" në kuadër të vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarisë mësimore dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë, bazuar në Nenin 103 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe akteve nënligjore në zbatim të ligjit, si dhe në Statutin e Kolegjit Universitar "Qiriazi" neni Nr.51 "Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë" ka hartuar dhe administruar procesin e plotësimit të pyetësorëve nga pedagogët e Kolegjit Universitar "Qiriazi". Pas përfundimit të këtij procesi po ju përcjellim dhe relacionin përkatës.

Drejtuese e NJSBC
Dr. Ida KRUTI







KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

KOLEGJI UNIVERSITAR "QIRIAZI"
NJËSIA E SIGURIMIT TE BRENDSHËM TË CILËSISË

Adresa: Kodër - Kamëz, Tiranë. www.qiriazi.edu.al, Tel/Fax: ++355 47 200 111; Mob. ++355(0)69 40 94 516

RELACION I PYETËSORIT TË STAFIT AKADEMIK





KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

Relacion Përmbledhës për Pyetëtorin e Pedagogut për Programet e Ciklit të Parë të studimit Bachelor, Ciklit të Dytë të studimit Master i Shkencave dhe Master Profesional, si dhe për Programet me Karakter Profesional të Lartë


Përfundimet e Analizuara nga Pyetëtorët e Pedagogëve për

Vitin Akademik 2023 – 2024

Bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në: Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Statutin e Kolegjit Universitar "Qiriazhi" (2021), Rregulloren e Kolegjit Universitar "Qiriazhi" (2022), "Politikat për Sigurimin e Cilësisë" dhe rregulloren mbi "Organizimin dhe Funkcionimin e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë" së Kolegjit Universitar "Qiriazhi" (2023), Strategjinë për Sigurimin e Cilësisë në KU "Qiriazhi" (2023 – 2028), si dhe në përputhje me Plan Veprimin Vjetor të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për vitin akademik 2023 – 2024 ka miratuar plotësimin e Pyetëtorit të Pedagogut për të gjitha ciklet dhe programet e studimit.

Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Kolegjit Universitar "Qiriazhi" për kryerjen e misionit të saj në shërbim të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies, përmirësimin e shërbimeve ndaj studentëve dhe stafit akademik ka marrë përsipër detyrat:

1. Mbështetje dhe sigurim të kërkimeve për gjetjen dhe evoluimin e mekanizmave për sigurimin e cilësisë. Kërkimet e gjetjeve fokusohen duke vlerësuar në veçanti përdorimin e mësimdhënies bashkëkohore, të mësuarit dhe vlerësimin e studentëve me qëllim promovimin e një qasjeje interaktive me studentin në qendër.
2. Përdorimin dhe gjetjen e mekanizmave, të cilat do të rrisin dhe përmirësojnë cilësinë dhe efikasitetin e marrëdhënieve midis institucionit dhe stafit akademik





NJSBC ka marrë përsipër hartimin dhe administrimin e Pyetësorit të Pedagogut. Qëllimi i përdorimit të këtij pyetësi konsiston në ndihmën që i jep institucionit për të kuptuar më mirë përmes përgjigjeve të pedagogëve pikëpamjet që stafi ka për institucionin në tërësi. Pyetësi është anonim, gjë që lejon shprehjen e mendimit të lirë nga ana e pedagogëve. Në shërbim të rritjes së cilësisë, institucioni ynë po bën përpjekje të vazhdueshme për të adoptuar politika dhe strategji të reja në lidhje me kriteret e cilësisë, rritjen e mëtejshme të standarteve ekzistuese në kuadër të hapësirës mbarë Europiane të Arsimit të Lartë. Funksionet e NJSBC shihen nga institucioni si pjesë integrale e rëndësishme e menaxhimit të procesit didaktik, por njëkohësisht si një instrument matës për rritjen e performancës së institucionit tonë.

Bazuar në një nga detyrat e përcaktuara si pjesë e veprimtarisë së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë u morën dhe analizuan përfundimet e nxjerra nga pyetësorët e plotësuar prej pedagogëve.

Pyetësi i Pedagogut përbëhet nga disa grup pyetjesh, duke filluar nga ato me karakter demografik, mbi aspektin didaktik, duke vijuar me grup pyetjesh mbi marrëdhëniet e pedagogëve me institucionin, pyetjet që lidhen me trajtimin financiar e duke përfunduar me një hapësirë mbi shprehjen e nevojës për përmirësimin e performancës së tyre.


Lidhur me **aspektin demografik** të të anketuarve në pyetësor morën pjesë 28 pedagogë, nga të cilët 50% femra, 36% meshkuj dhe 14% persona të cilët nuk kanë dhënë të dhëna në lidhje me moshën.





KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI


Pyetësori është plotësuar nga grupmosha të ndryshme duke filluar nga 25 deri mbi 55 vjeç. Të dhënat e detajuara i gjeni në grafikun e mëposhtëm:




Nga pedagogët e anketuar pjesa më e madhe e tyre japin mësim në disa cikle studimi përkatësisht, ciklin e parë dhe të dytë të studimeve, në ciklin Bachelor, Master i Shkencave dhe njëkohësisht dhe në Kolegjin Profesional të Lartë. Rreth 85 % e tyre japin mësim në ciklin e parë të studimeve Bachelor, pedagogë të angazhuar vetëm në Kolegjin Profesional të lartë përbëjnë rreth 22 %, ndërsa vetëm një prej të anketuarve nuk ka dhënë informacion mbi ciklin ku japin mësim.

Lidhur me grupin e dytë të pyetjeve, që i referohen *aspektit didaktik* të pyetur mbi frekuentimin e studentëve pjesa më e madhe e pedagogëve është shprehur *pozitivisht*. Pjesa më e madhe e pedagogëve 78.5 % shprehen se studentët frekuentojnë nga 61% - 90 % mësimin, dy prej tyre nuk kanë janë përgjigjur, 28 % e pedagogëve shprehen se studentët frekuentojnë nga 51 deri më pak se 50%.

Lidhur me shfrytëzimin e kohës së mësimin nga studentët gjatë seminareve, pedagogët shprehen në masën 89.2% se, pjesëmarrja e studentëve është në nivel “mesatar” dhe “i lartë”, ndërsa 1 prej tyre shprehet me vlerësimin “e ulët”.




Disa nga pohimeve që i referohen shqetësimeve gjatë procesit mësimor, ku pedagogët mund të përzgjidhnin disa prej tyre. Detajet e përgjigjeve janë paraqitur grafikisht më poshtë:



Në pyetjen drejtuar pedagogëve mbi ndërhyrjen e strukturave drejtuese për vlerësimin e studentëve rreth 82% e tyre shprehen “asnjëherë”, dy prej tyre shprehen “ndonjëherë”pa specifikuar nga cila njësi drejtuese, ndërsa tri prej tyre nuk kanë dhënë përgjigje.

Pyetjet drejtuar pedagogëve mbi strukturat didaktike të vendosura në dispozicion të tyre pjesa më e madhe e pedagogëve përgjigjen *pozitivisht*. Kështu rreth 78.5 % janë përgjigjur se kompletimi me mjete didaktike është “i plotë”, dy prej tyre janë përgjigjur “mesatarisht i plotë” për kategorinë “projektorë”. 89.2 % e pedagogëve shprehen se në institucion kanë akses të internetit dhe 75% e tyre e përdorin atë shpesh në procesin mësimor, ndërsa 6 prej tyre shprehen “ndonjëherë” dhe një person nuk ka dhënë përgjigje.

Të pyetur mbi hapësirën fizike të mjedisit të punës në shkallët e vlerësimit nga 1- 10 (ku 1 është vlere më e ulët është, ndërsa 10 vlere më e lartë), rreth 95 % e stafit shprehen nga shkalla 7-10, një person ka vlerësuar me shkallën 1. Lidhur me pyetjen e pedagogëve mbi vendosjen në dispozicion të tyre të pajisjeve të zyrave, mjeteve kancelerike dhe kompjutrave me vlerësim nga shkalla 1 – 10 rreth 95% e stafit shprehen nga shkalla 7 -10, pjesa tjetër ka vlerësuar me shkallën një, tre dhe katër.




Të pyetur mbi ngarkesën e punës duke përcaktuar një shkallë nga 1 deri në 10 rreth 50% e pedagogët kanë përzgjedhur nga 1 deri në 5. Afërsisht 22 % e tyre kanë përzgjedhur mes shkallës 6-të dhe 9-të, pjesa tjetër ka përzgjedhur shkallën 10.


Lidhur me pyetjen mbi pavarësinë dhe lirinë akademike 85.57 % e pedagogëve kanë përzgjedhur nga shkalla 7 deri në shkallën 10, pjesa tjetër kanë përzgjedhur nga shkalla 1 deri në 6.

Përsa i takon grupit të pyetjeve që lidhen me **marrëdhëniet me institucionin** të tilla si vlerësimin mbi përfshirjen e pedagogëve nga ana e strukturave në vendimmarrje me shkallë vlerësimi nga 1 deri në 10, afërsisht 89 % e pedagogëve kanë përzgjedhur nga shkalla 7 deri në 10, pjesë tjetër kanë përzgjedhur një shkallë vlerësimi nga 1 deri në 4 dhe afërsisht 6 % nuk i janë përgjigjur pyetjes.

Përgjigjet e pedagogët lidhur me vlerësimin e performancës së tyre nga titullari i gjeni të detajuara në grafikun e mëposhtëm



Lidhur me pyetjet për **trajtimin financiar** në lidhje me trajtimin financiar për punën e kryerjes me shkallë vlerësimi nga 1 deri në 10, 64 % e pedagogëve kanë vlerësuar nga shkalla 7 deri në 10, ndërsa pjesa tjetër kanë dhënë vlerësimin nga 1 – 6. Nërsa lidhur me korrektesën e kryerjes së pagesave nga ana e institucionit afërsisht 86 % kanë zgjedhur nga shkalla 5 – 9, pjesa tjetër kanë përzgjedhur nga shkalla 1-3.



KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

Lidhur me grupin e fundit të pyetjeve mbi *shprehjen e nevojës për përmirësimin e performancës* së tyre disa nga komentet kishin të bënin me dhënien më tepër të lirisë akademike, uljen e ngarkesës akademike dhe administrative, informimi me të rejtat në fushat specifike, vendosjen në dispozicion të një fondi për kërkimin shkencor duke iu mundësuar atyre botime, vendosjen në dispozicion të literaturës bashkëkohore dhe zgjerimin e bibliotekës me tituj të rinj, si dhe korrektesa në paga.


Si përfundim mund të thuhet se mendimet e pedagogëve ishin kryesisht positive në lidhje me studentët, strukturën e kolegjit dhe mjeteve didaktike në dispozicion të tyre.

Institucioni sugjerohet:

Të bëjë më tepër përpjekje dhe të gjejë hapësira në përfshirjen e pedagogëve në vendimmarrje në funksion të inkurajimit dhe bashkëpunimit të brendshëm institucional.

Shtojca 1: Përmbledhje e Pyetësorëve

Shtojca 2: Pyetësi i Pedagogut



Shtojca 1

PYETËSOR PËR MBLEDHJEN E OPINIONEVE TË PEDAGOGËVE(PAE)

I. TË DHËNA MBI PEDAGOGUN/EN

1. Moshë

Moshë e Pedagogëve	
25-35	4
35 - 45	5
45 - 55	5
mbi 55 vjec	13
Pa përgjigje	1

2. Gjinia

Femra	14
Meshkuj	10
Pa Përgjigje	4


II. TË DHËNA PËR PROCESIN MËSIMOR (Rretho ose nënvizo)

1. Në çfarë cikli jepni mësim?

Profesional	13
Cikli i parë	24
Cikli i dytë	6
Pa përgjigje	1

2. Në çfarë viti jepni mësim?

Profesional	Viti parë	11
	Viti dytë	5
Cikli i parë	Viti parë	17
	Viti dytë	11
	Viti tretë	12
Cikli i dytë	Viti parë	5
	Viti dytë	3



3. Në çfarë simestri jepni mësim?

Sem.I	25
Sem.II	21
Pa Përgjigje	1

4. Forma e dhënies së mësimi:

Me kohë të plotë	28
------------------	----


III. VLERËSIMET PËR PROCESIN MËSIMOR

1. Afërsisht sa mendoni se ka qenë frekuentimi në auditore (leksione & seminare) nga ana e studentëve në lëndët që trajtoni në KUQ?

më pak se 50%	4
51 - 60%	4
61 - 70 %	4
71 - 80%	7
81 - 90 %	5
më shumë se 90%	2
Pa përgjigje	2

2. Si do e vlerësonit kompletimin me mjete didaktike si tabela, projektorë, video, etj KUQ-në?

MJETI	VLERËSIMI			Abstenim
	Jo i plotë	Mesatarisht i plotë	i plotë	
Tabela		3	21	4
Projektorë	1	2	22	3
Video		3	17	8
Të tjera			17	11



3. Sa janë përdorur nga ana juaj mjete didaktike si tabela, projektorë, video etj:

MJETI	VLERËSIMI				
	Aspak	Pak	Mesatarisht	Shumë	Abstenim
Tabela		3	2	20	2
Projektorë		2	2	23	1
Video	1	5	2	12	8
Të tjera	1	2	2	4	19

4. A ka lidhje interneti në shkollë?

Po	JO	Pa Përgjigje
25	1	2

5. Nëse PO, cila është cilësia e internetit? Vlerëso nga 1 në 10


1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
				2	3	3	7	7	5

6. Jepni mendimin tuaj mbi nivelin e përdorimit të internetit gjatë procesit mësimor.

	VLERËSIMI			
	Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Abstenim
Përdorimi i internetit		6	21	1

7. Ju lutem shprehni mendimin tuaj për shkallën e shfrytëzimit të kohës/ores të mësimit nga studentët gjatë zhvillimit të seminareve, për çdo lëndë që trajtoni në KUQ?

E ulët	Mesatare	E lartë	Abstenim
1	16	9	2



8. Jepni komentimin tuaj për aktivizimin e studentëve në jetën universitare apo vendimmarrje:

Disa nga komente janë:

Pjesëmarrës në komisione

Japin mendime që merren konsideratë në mbledhjet e senatit, NJSBC dhe komisione si, ai i etikës etj.

Aktiv në panairë

Aktiv lidhur me botën e biznesit

Aktiv në klubet studentore

Pak

Mirë

Mjaftueshëm

9. Çfarë u ka shqetësuar më shumë në fushën e mësimin dhe veprimtarive të tjera në këtë vit akademik:

1. Mungesa e seriozitetit nga ana e studentëve
2. Mungesa e librave të përshtatshëm
3. Mungesat e studentëve në leksione dhe seminare
4. Mungesa e përgatitjes së tyre në seminare
5. Mungesa e përgatitjes së tyre në provimin përfundimtar
6. Mos dorëzimi fare i detyrave të kursit (eseve)
7. Mos dorëzimi në kohë i detyrave të kursit (eseve)
8. Dorëzimi i detyrave të kursit (eseve) me mangësi në formë dhe përmbajtje

Po

3	
2	
9	
10	
6	
2	
17	
10	


10. A është vlerësuar ndonjëherë performanca juaj nga eprori dhe njësi të caktuara të KUQ-së?

Nuk e di	Jo	Po	Abstenim
1	1	22	3

11. Jepni mendimin tuaj për përmirësimin e mëtejshëm të procesit mësimor:

1. Si e vlerësoni në KUQ hapësirën fizike të mjediseve tuaja të punës?

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
	1					3	6	8	10



2. Si e vlerësoni pajisjen e zyrës me kompjutera apo mjete kancelerie?

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1		1	1			3	7	8	7

3. Si e vlerësoni bashkëpunim e personelit me Ju?

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
				2		4	4	8	10

4. Si e vlerësoni informacionin që vihet në dispozicion në lidhje me disiplinat që trajtoni?

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
				2	1	6	4	8	7

5. Si e vlerësoni ngarkesën tuaj të punës?

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
3				10	1	2	3	1	8

12. Jepni mendimet tuaja për sa më poshtë:


1. Si e vlerësoni pavarësinë tuaj në lidhje me lirine akademike?

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1			1		2	3	3	2	16

2. Si e vlerësoni trajtimin financiar për punën që kryeni?

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
2	1		1	3	3	4	5	9	

3. Si e vlerësoni korrektësinë e kryerjes së pagesave nga ana e institucionit?



KOLEGJI
UNIVERSITAR
QIRIAZI

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
3		1		2	1	1	14	6	

4. Sa jeni të përfshirë nga ana e strukturave drejtuese në vendimmarrje?

1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
1	1		1		3	4	5	7	6

5. Vlerësoni ndërhyrjen nga ana e strukturave drejtuese për vlerësimin e studentëve?

Asnjëherë	Ndonjëherë	Shpesh	Abstenim
23	2		3

6. Nëse kjo "Ndodh" specifikojë më poshtë:

Struktura drejtuese	Po	Jo
Njësia bazë		
Njësia kryesore		
Rektorati		
Administratori		
Të tjerë		

13. Çfarë mund t'ju ndihmonte ju në përmirësimin e performances tuaj?

Disa nga komentet janë:

Lidhja me tregun e punës

Sistemi online i institucionit

Biblioteka, literatura bashkëkohore Informimi me të rejtat në fushën specifike

Vendimmarrjet të jenë kolegjiale lidhur me komponentet e procesit mesimor
plane mësimore etj

Pjesëmarrje studentësh dhe bashkëpunim me studentët

Vlerësimi financiar